



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.71, datë 28.06.2021

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 127'823'334 LEKË PA TVSH, TË PËRFITUAR NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 334, DATË 2.6.2021 "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NË BASHKITË DURRËS, KAMZË, VORË, SHIJAK DHE MIRDITË"

Në zbatim të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", Aktit Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Ligjit Nr.68/2017,"Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit Nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 334, datë 2.6.2021 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, në bashkitë Durrës, Kamzë, Vorë, Shijak dhe Mirditë", si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 127'823'334 lekë pa tvsh, të përfituar në zbatim Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 334, datë 2.6.2021 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, në bashkitë Durrës, Kamzë, Vorë, Shijak dhe Mirditë", për financimin e rindërtimit të banesave individuale, për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si

objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bashkinë Durrës i detajuar sipas tabelës së mëposhtme:

VKM që ka miratuar fondin	Gr.	Kap	Progami	Llog. ekon	Kodi i produktit	Emërtimi i projektit	Fondi në lekë
NR.334 DT.2.6.2021	00	6	04960	606	94902AC	Financimi i rindërtimit të banesave individuale për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit , banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.	127,823,334
						TOTALI	127,823,334

- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).




KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.06.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 451/prot.
3



Durrës, më 01.07., 2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.71 datë 28.06.2021: Për miratimin e përdorimit të fondit prej 127.823.334 lekë pa tvsh, të përfituar në zbatim të VKM Nr 334 datë 02.06.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në Bashkitë Durrës, Kamëz, Vorë, Shijak dhe Mirditë”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

